

LIGJ
Nr.8274, datë 14.1.1998

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SHQIPTARE DHE
QEVERISË MAQEDONASE PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT
DIPLOMATIKE E TË SHËRBIMIT DHE PËR NIVELIN E TAKSËS NË DHËNIEN E
LLOJEVE TË TJERA TË VIZAVE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike e të shërbimit dhe për nivelin e taksës në dhënie të llojeve të tjera të vizave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1988, datë 19.1. 1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani